

Në seancën e mbajtur në këtë gjykatë trashëgimtarët e rendit të dytë dhe e autorizuar e disa trashëgimtarëve kan deklaruar se dëshmi vdekjet e datave ..., ..., ..., janë të saktë, të ndjeri nuk kanë lënë trashëgimtarë të tjerë pos atyre të shënuar në dëshmi vdekjet.

Gjykata pasi vërtetoi se pjesëmarrësit janë trashëgimtarë ligjor, të rendit të dytë e në kuptim të nenit 12 të Ligjit për Trashëgimi të Kosovës, e duke u bazuar në deklaratën e dhënë të pjesëmarrësve, për trashëgimtarë i shpalli: B. (Z...) D., S. (A...) D., V. (A...) D. dhe A.(R...) D. që të gjithë nga Hani i Elezit, konform nenit 171.1 të Ligjit mbi Procedurën Jokontestimore Nr. 03/L-007.

Gjykata për trashëgimtar nuk i shpalli: Xh.(Z...) S. nga Hani i Elezit, sepse përmes të autorizuarës ka deklaruar se heq dorë nga e drejta në trashëgimi, I. (A...) R. nga Kaçaniku, A. M. nga Hani i Elezit, G. F. nga ..., sepse në seancën për shqyrtimin e trashëgimis kanë deklaruar se heqin dorë nga e drejta në trashëgimi. V. K. nga fshati.. Hani i Elezit, N. D. dhe B. D. nga Hani i Elezit përmes të autorizuarës M.K.-B. avokate nga Kaçaniku kan deklaruar se heqin dorë nga e drejta e trashëgimisë. Trashëgimtarët L. D. dhe I. D. nga Hani i Elezit, në seancë kanë deklaruar se heqin dorë nga e drejta në trashëgimi. D. L. nga Kaçaniku, S. D. nga Hani i Elezit dhe S. K. nga fshati ... Hani i Elezit, në seancën dëgjimore kanë deklaruar se nuk e pranojnë pjesën e pasurisë që i takon sipas ligjit. Trashëgimtarët Xh. R. dhe B. D. nga Hani i Elezit, përmes të autorizuarës M. K.-B. avokate nga Kaçaniku kanë deklaruar se heqin dorë nga e drejta në trashëgimi. O. D. nga Hani i Elezit e veja e Z. D., A. D. nga Hani i Elezit e veja e A. D., H. D. nga Hani i Elezit e veja e R. D. nuk janë shpallë trashëgimtarë sepse kjo e drejt nuk ju takonë, sepse me nenin 12 pik 1 të Ligjit për Trashëgimi i Kosovës Nr.2004/26 këto persona nuk hynë në radhët e trashëgimisë.

Ndërsa sa i pëket trashëgimtares S. S. nga Shkupi e bija e të ndjerit E. D. ka vdekur këtë faktë gjykata e ka vërtetuar nga certifikata nga libri për të vdekur e datë ..., e lëshuar nga Shkupi. Ndërsa se nuk ka lënë trashëgimtar pas vete këtë faktë gjykata e ka vërtetuar nga deklaratat e trashëgimtarve prezent në gjykatë të cilët nën përgjegjësi morale edhe penale kanë deklaruar se e njejta nuk ka lënë trashëgimtarë.

Gjykata duke u mbështetur në deklaratat e trashëgimtarëve, të autorizuarës së disa trashëgimtarëve të dhën në seancën e shqyrtimit të trashëgimisë, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata në konsultim me pjesëmarrësit në trashëgimi konstatoi se vlera e masës trashëgimore është në shumë prej 50.000€

Meqë trashëgimtarët kanë hequr dorë nga e drejta e ankesës ky aktvendim është i plotfuqishëm nga data 01.07.2022.

Gjykata e detyroi palën propozuese që ta paguaj shumën prej 100 € në emër të taksës për propozim, sepse pala propozuese nuk e ka paguar taksën me rastin e dorëzimit të propozimit gjykatë me rastin e vendosjes për shpenzimet veçori konform neneve 29 të LPJ si dhe nenit 453.4 të LPK-së. Gjykata taksën e ka caktuar konform Udhëzimit Administrativ numër 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore.

Nga sa u theksua më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Dega në Kaçanik

Ct.nr.10/21 prej datës 01.07.2022

Gjyqtari:

Riza LIVOREKA